



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 48

Prishtinë, më 7.6.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivkoviç, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviç, Slavko Simiq, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Agim Çeku, Fisnik Ismaili, Rrustem Berisha, dhe Qerim Bajrami.

Pjesëmarrës të tjerë : përfaqësues nga OSBE-ja, Senad Karaahmetoviç; përfaqësuese nga KDI-ja, Mërgime Kajtazi; konsultant i Sekretariatit të KKK-së, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtpria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivkoviç**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur, më 11.05.2016;**
3. **Shqyrtimi i Informacionit lidhur me vizitën zyrtare të delegacionit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Republikën e Kroacisë;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-087 për Kundravajtje me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;**
5. **Shqyrtimi i ekspertizës së KDI-së lidhur me Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës (konkretisht neni 11), në përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil;**
6. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur, më 11.05.2016;**

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 11.05.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Informacionit lidhur me vizitën zyrtare të delegacionit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Republikën e Kroacisë;

Kryesuesja – theksoi se në përputhje me interesat e paraqitura në nivelin diplomatik, Komisioni ka realizuar vizitën zyrtare në Kuvendin e Republikës së Kroacisë, më 16 - 17 maj 2016. Delegacioni, gjatë qëndrimit në Kuvendin e Kroacisë, ka qenë i interesuar të njoftohet me fushën e legjislacionit të ligjeve që janë miratuar dhe harmonizuar me standardet Evropiane dhe janë në interes në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komuniteteve. Gjithashtu, delegacioni ka marrë përvoja të mira lidhur me rregullativën e tyre juridike, çështjet e marrëdhënieve pasurore – juridike, arsimimin e pakicave dhe integrimi i tyre në sistemin shtetëror të Kroacisë, në mënyrë që shumë çështje të zgjidhen.

Në kuadër të bashkëpunimit ndër-parlamentar, Komisioni ka hartuar informacionin, i cili do të procedohet për miratim në Kryesi.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, në mënyrë unanime, vendosi që të paraqesë këtë:

Përfundim

Miratohet Informacioni lidhur me vizitën e delegacionit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në Republikën e Kuvendit të Kroacisë dhe e njejtat të procedohet për miratim në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-087 për Kundravajtje me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-087 për Kundravajtje dhe raportin me amendamente të Komisionit funksional dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen, nëse kanë ndonjë vërejtje.

Pas shqyrtimit të projektligjit dhe raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-087 për Kundravajtje dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i ekspertizës së KDI-së lidhur me Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës (konkretisht neni 11), në përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil;

Kryesuesja konsideroi se anëtarët e Komisionit e kanë marrë me kohë draftin e ekspertizës lidhur me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 11.

Për zgjidhje e gjendjes aktuale, propozoi të mbahet Dëgjim Publik, ku diskutimi do të zhvillohet me të gjitha institucionet e interesuara në nivel qendror, me ambasada të huaja në Kosovë, me organizatat joqeveritare, që të ofrojnë informatat e nevojshme, të cilat referohen në këtë Ligj.

Lidhur me këtë çështje fjalën ia dha kryetarit të GP, Veton Berisha.

Veton Berisha, përkrah gatishmërinë dhe përgjegjësinë e ekspertit të KDI-së, z. Shefqet Berishën, i cili gjatë hartimit të hulumtimit parlamentar, ka shqyrtuar dhe analizuar dispozitat ligjore të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, konkretisht nenin 11. Gjithashtu, veçoi se dokumenti përmban rregulla statusore të nëpunësve civilë, menaxhimi dhe organizimi i përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, në institucionet qendrore dhe lokale, ku rezulton se pamundësohet përfaqësimi i drejtë dhe proporcional i komuniteteve jo shumicë. Që të tejkalohet kjo situatë, gjithsesi kërkohen ndryshime përkatëse dhe një qasje e re e zbatimit të politikave të veprimit dhe të administrimit në shërbimin civil.

Sa i përket organizimit të Dëgjim Publik, propozoi që të ftohen; Ministri i financave, ministri i Administrimit Publik, Ministri dhe zëvendësministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministri për Komunitete dhe Kthim, Këshilli i i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshillin Konsulltativ për Komunitete pranë Zyrës së Presidentit, kordinatori i zyrës ligjore të Kabinetit të Kryeministrit, drejtori ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës, zyrtari i lartë ligjor të Kabinetit të Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, ambasadat e huaja në Kosovë; Ambasada Gjermane, Norvegjeze, Suedeze dhe SHBA-ve. Gjithashtu, të ftohen përfaqësues të shoqëris civile dhe Mediat e Kosovës.

Gjithashtu, në këtë dëgjim publik do të bëhet edhe prezantimi i hulumtimit parlamentar lidhur me zbatimin e ligjit, i përkrahur nga KDI-a.

Artan Murati, zyrtar ndërlidhës nga KDI-ja, theksoi se hulumtimi parlamentar, është raport përmbledhës lidhur me gjendjen aktuale të shërbysve civil në Kosovë.

Projekti i Hulumtimit Parlamentar, përmban vlerësimin e përfaqësimit të drejtë dhe proporcional të komuniteteve jo shumicë, si dhe të dhënat statistikore për punësimin e nëpunësve civilë në shërbimin civil, të komuniteteve jo shumicë.

Ai veçoi se Instituti Demokratik i Kosovës është i gatshëm të ofrojë përkrahje rreth organizimit të Dëgjimit Publik. Ai propozoi që të caktohet takimi me datë 20.06.2016, duke filluar në ora 10:00, në Hotel 'Sirius' në Prishtinë.

Kryesuesja, pas konsultimeve, kryesuesja konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

Obligohet administrata për mbështetje të Komisionit që në bashkëpunim me Institutin Demokratik të Kosovës, të kryej të gjitha pregaditjet për mbajtjen e Dëgjimit Publik, për datë 20.6.2016, në Hotel 'Sirius' në Prishtinë, lidhur me zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës (konkretisht neni 11), në përfaqësimin e komuniteteve jo shumicë në shërbimin civil. Në këtë takim do të bëhet edhe prezantimi i hulumtimit parlamentar lidhur me zbatimin e ligjit, i përkrahur nga Instituti Demokratik i Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković